

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ekspertja kanadeze për skandalin e SHISH: Hetim i plotë për të zbuluar nëse ka një rrjet
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/28/ekspertja-kanadeze-per-skandalin-e-shish-hetim-i-plote-per-te-zbuluar-nese-ka-nje-rrjet/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 18:40:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 18:37:51 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8351e0c8d8b38c8798885421b680ce049ac78d98f3264aefcb7b375831709025
TEKSTI	f4cc320368c163b6065bc5849a600cc15efaf4adcbbff9ca80662dbcd3bf9cae
PAMJA	7fd9b94393c5280e3ab9139a3940d54a140d44239d4dcf0f34e392dc4c4d63b3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	221f1b0ada913dd7ed58742211b8693d4a56cee8e41fc5fbbcb8b0389dd70fd7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	1fd94ce259103b5d3a93736e630fca63414b31f94ba022dd5b4f87109ff485e9
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/221f1b0ada913dd7ed58742211b8693d4a56cee8e41fc5fbbcb8b0389dd70fd7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Ekspertja kanadeze për skandalin e SHISH: Hetim i plotë për të zbuluar nëse ka një rrjet

20:37 : 28/09/2026 në AKTUALITET, KRONIKE, Lajmet e Dites



Ekspertja kanadeze e sigurisë kombëtare, Stephanie Carvin, e ka cilësuar si një ngjarje fatkeqe skandalin që lidhet me ish-drejtoreshën e SHISH, Vlora Hyseni, dhe dyshimet për transmetim të informacionit të klasifikuar të biznesmenit Ergys Agasi.

Në një intervistë në A2 CNN, Carvin tha se raste të tilla përbëjnë një shqetësim serioz për sigurinë kombëtare, sidomos kur një person me akses të privilegjuar në informacion dyshohet se e ka keqpërdorur atë.

Ajo theksoi se një nga pyetjet kryesore që duhet të marrë përgjigje është nëse bëhet fjalë për veprim individual apo nëse pas ngjarjes fshihet një rrjet më i gjerë.

“Është gjithmonë një sfidë, sepse kemi të bëjmë me operacione shumë sekrete dhe, në të njëjtën kohë, me nevojën për drejtësi publike. Jo gjithmonë është e lehtë, sepse gjatë hetimeve mund të dalin në publik informacione operacionale. Prandaj duhet treguar kujdes. Por kur një ngjarje e tillë trondit besimin, gjëja më e rëndësishme është rikthimi i këtij besimi.

Një hetim i plotë dhe sa më transparent që të jetë e mundur është shumë i rëndësishëm. Hetimi duhet të jetë i ndershëm, por edhe efikas, në mënyrë që e vërteta të dalë sa më shpejt dhe çështja të mos zvarritet. Gjithashtu, nëse ka indicie për lidhje të tjera, duhet të përcaktohet nëse kemi të bëjmë me një individ që ka vepruar i vetëm apo me një rrjet më të gjerë”, theksoi ajo.

Lexo edhe:[Kur skandali kthehet në sukses/ Anatomia e një fjalimi të Edi Ramës](#)[Këshilli i Sigurisë përforcon alibinë e Ramës për Vlora Hysenin](#)

Carvin solli edhe raste nga Kanadaja, duke theksuar se probleme të ngjashme janë shfaqur edhe në vende të tjera anëtare të NATO-s. Ajo përmendi rastin e ish-zyrtarit kanadez Cameron Ortis, i cili është akuzuar për transmetim informacioni të persona të lidhur me botën kriminale.

Sipas saj, keqpërdorimi i informacionit të klasifikuar mund t'u japë grupeve kriminale mundësi të kuptojnë se si po zhvillohen hetimet ndaj tyre dhe t'i ndihmojë të shmangin

TË GJITHA

Ekspertja kanadeze për skandalin e SHISH: Hetim i plotë për të zbuluar nëse ka një rrjet

20:37 : 28/09/2026



Nga dorëheqja e Ramës të qeveria teknike, aktivistja rikujton kërkesat e protestuesve

20:22 : 28/09/2026



Mbledhja e Këshillit të Sigurisë, protestuesi: Tentativë për të hequr përgjegjësinë e Ramës nga skandali i SHISH

20:22 : 28/09/2026



Ukraina raporton bombardime vdekjeprurëse ruse në Kiev

20:11 : 28/09/2026



Vihet nën kontroll zjarri në Fieri, tre persona shoqërohen në polici

20:09 : 28/09/2026



Biznesi i verës, firma e ndërtimit dhe tenderat/ Si u shumëfishua pasuria e çiftit Ergys-Dorina Verdho

19:55 : 28/09/2026



WSJ: Si e ndihmoi ambasadorja amerikane "Aktor Group" të siguronte marrëveshjen 6 mld dollarësh në Shqipëri

19:48 : 28/09/2026

përgjimet apo operacionet e autoriteteve.

“Kur dikush abuzon me informacionin në këtë mënyrë, dëmton institucionin në disa drejtime. Fillimisht dëmton reputacionin e organizatës, por gjithashtu mund të pengojë drejtpërdrejt hetimet kriminale dhe punën e shërbimeve të inteligjencës”, deklaroi Carvin.

Ekspertja paralajmëroi gjithashtu për një tjetër pasojë të mundshme, dëmtimin e marrëdhënieve me partnerët ndërkombëtarë. Sipas saj, nëse një aleat humbet besimin se informacionet sensitive do të mbrohen, mund të bëhet më i rezervuar në ndarjen e të dhënave të klasifikuara.

“Personat përgjegjës duhet të mbahen para përgjegjësisë, nëse fajësia e tyre provohet. Kjo është mënyra se si mund të rikthehet besimi i publikut”, përfundoi ajo.

Etiketa: Ekspertja kanadeze ish-drejtoresh e SHISH nato vlora hyseni

Lajme të lidhura



Kur skandali kthehet në sukses/ Anatomia e një fjalimi të Edi Ramës

18:28 : 28/09/2026



Këshilli i Sigurisë përforcon alibinë e Ramës për Vlorë Hysenin

17:53 : 28/09/2026



“Alibia e Ramës ka rënë”, Bardhi: Të japë llogari për SHISH-in dhe Vlorë Hysenin, përgjegjësia politike është e tij

12:30 : 28/09/2026



Kryediplomati polak: Rusia nuk ka forcë për sulm ndaj NATO-s

10:16 : 28/09/2026



Një histori korruptimi jo dashurimi

16:55 : 27/09/2026



Rama sulmoi drejtësinë për Vlorë Hysenin/ Tabaku: Shqipëria vuan nga një republikë e të korruptuarve

16:42 : 27/09/2026



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ

